Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0416

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së OE N.N.SH. " Vizion Project ", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë" me numër të prokurimit 207-23-2085-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, më 03/08/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e N.N.SH. " Vizion Project " me nr. 2023/0416, e datës 19/06/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë", me numër të prokurimit 207-23-2085-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, ndërsa vendimi i AK, lidhur me aktivitetin e lartcekur VERTETOHET.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportitnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 14.03.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë" me numër të prokurimit 207-23-2085-2-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 50,000.00 €.

Me datë 18.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpallur fitues operatorin ekonomik ankues "GM Architecture" Sh.P.K. Me datë 20.04.2023 operatori ekonomik ankues N.N.Sh. "Vizion Project" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 24.04.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka miratuar si të bazuar pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues ashtu që aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim.

Pas procedurës së rivlerësimit, me datë 02.06.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpallur fitues operatorin ekonomik ankues "GM Architecture" Sh.P.K. Me datë 07.06.2023 operatori ekonomik ankues N.N.Sh. "Vizion Project" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 të Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 08.06.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Duke qenë i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues, operatori ekonomik ankues me datë 19.06.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 416/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor: "*Pretendimi që z.Sh. O. i mungon specializimi për konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore nuk qëndron për arsye se askund tek Dëshmitë e kërkuara dokumentare (neni 9.1 & 9.2 i FDT-së) nuk kërkohet asnjë dokument, çertifikatë apo dëshmi e specializimit në konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore, por kërkohet vetëm diplomë e noterizuar, gjë që është prezentuar nga ne si OE pjesëmarrës. Për më tepër, nga dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas kërkesave të FDT-së për z.S O. përveç kontratës, aneks-kontratës dhe diplomës së noterizuar si Inxhinier i Arkitekturës janë prezentuar edhe referenca të përvojës në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë arkitekturore, të lëshuara nga institucioni i specializuar për konservim dhe restaurim të trashëgimisë kulturore – Cultural Heritage Without Borders - CHWB për projekte të kësaj natyre të kryera nga z.Shkëlqim Osmani që nga viti 2006 e në vazhdimësi të cilat deshmojnë shumë mire përvojen dhe specializimin e tij ne konzervim dhe restaurim. Po ashtu janë prezentuar edhe referenca në*

fushën e projektimit në objekte kulturore, ashtu siç është kërkuar në FDT".

Pretendimi i dytë (II) ankimor: "*Sa i përket pretendimit tjetër të AK ku thuhet: Tek kriteri – Caktimi i Menaxherit të kontratës, - Dëshmia: Vendimi për caktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet të jetë njëri nga arkitektet e paraqitur të lista e stafit professional. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emri i Autoritetit, Emërtimin e procedures dhe numrin e prokurimit). OE nuk ka prezantuar nje vendim të caktimit të projekt menaxherit te kontratës. Dëshmia lidhur me këtë pretendim të AK: Ne kemi dorzuar Vendimin e Menaxherit të Projektit duke specifikuar emrin e AK, Titullin e Kontratës si dhe Numrin e Prokurimit dhe Numrin e Brendshem. Ne këtë Vendim ne kemi emruar z.Shkëlqim Osmani si Menaxher të Projektit i cili është Inxhinier i Arkitekturës me përvoj 16 vjeçare".*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59 dhe 69 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.06.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 30.06.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si vijon: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK*".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale.Autoriteti Kontraktues ankues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka dorëzuar te Paneli Shqyrtues njoftimin sipas të cilit nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se "*Eksperti Shqyrtuese ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit, përkatësisht pretendimit të OE ankues, sqaron si në vijim:*
AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2 ka përcaktuar si në vijim Kërkesa
1. Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës (Lejohet edhe me Master) – I specializuar për konservimi n dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore;
***Dëshmitë 1.** Kontratë e punës (e mbështetur edhe me një Aneks Kontratë për angazhim konkret në Procedurën e Prokurimit Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë me numër të prokurimit 207-23-2085-2-2-*
1. 2. Diploma e noterizuar 3. CV - e nënshkruar nga i angazhuari 4. Përvoja e punës të ketë përvojë pune tre vjeçare në fushën e projektimit në objekte kulturore, pas përfundimit të studimeve themelore, dhe të ketë së paku një reference fushën e projektimit në objekte kulturore. Përvoja duhet të mbështet edhe me Letër reference të lëshuar nga secila kompani apo institucion lidhur me angazhimin. Eksperti Shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktues
*në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, konkretisht te **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2,** si dhe duke marrë parasysh dëshmitë e prezantuara nga OE ankues, për inxhinierin e Diplomuar të Arkitekturës, z.Shkëlqim Osmani, Eksperti shqyrtues konsideron se, dëshmitë e ofruara nga OE ankues nuk e përmbushin kërkesën e lartë cekur të dosjes së tenderit. **Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.** Dëshmitë dhe referencat e prezantuara nga OE ankues, për z.S O.nuk janë të mjaftueshme, për faktin se, kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës (Lejohet edhe me Master) - I specializuar për konservimin dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore. Andaj, sipas dëshmive të paraqitura nga OE ankues, nuk mohohet fakti që z.S Oi ka përvojë dhe ka kryer aktivitete të tilla në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë arkitekturore, por meqenëse në kërkesën e lartë cituar, AK ka kërkuar Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës **(Lejohet edhe me Master) - I specializuar për konservimin dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore**, pra përveç referencave ku tregohet natyra e aktiviteteve, nuk ka prezantuar edhe dokumete tjera që tregojnë specializimin specifik për konservimin dhe restaurim të trashëgimisë arkitekturore. Andaj, konsideroj se në rastin konkret, kur përcaktohet si term në dosjen e tenderit **i specializuar**, nënkuptohet që të ketë njohuri dhe ekspertizë të veçantë e specifike në fushën përkatëse. Kështu që, si dëshmi e aftësisë në rastin konkret mund të dëshmohet me diplomë, certifikatë apo licencë për specializimin përkatës*".

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimin e parë të operatorit ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me këtë pretendim i ka

falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.**Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i Operatorit Ekonomik Ankues është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor eksperti shqyrtues përmes raportit të ekspertizës ka konstatuar se "*Eksperti Shqyrtuese ka shqyrtuar këtë pretendim ankimor, dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit në platformën e-prokurimit, përkatësisht pretendimit të OE ankues, sqaron si në vijim: AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht te* ***Kërkesat mbimundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2,*** *ka përcaktuar si në vijim:* ***Kërkesa*** *6. Caktimi i Menaxherit të kontratës;* ***Dështmitë 1.*** *Dështmia Vendimi për përcaktimin e menaxherit të kontratës, i cili duhet njëri nga arkitektet e parqitur të lista e stafit profesional. Vendimi duhet të përmbajë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedures dhe numrin e pro kurimit). Eksperti Shqyrtues, duke u bazuar në kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë, konkretisht te* ***Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionaleneni 9.1 & 9.2,*** *si dhe duke u bazuar në dështmitë e prezantuara nga OE ankues, lidhur me caktimin e Menaxherit të Projektit, Eksperti shqyrtues konsideron se dokumenti i prezantuar nga OE ankues i përmbanë të dhënat bazike mbi procedurën aplikuese (Emrin e Autoritetit, Emërtimin e procedures dhe numrin e prokurimit), sip as kërkesës në dosjen e tenderit.* ***Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i bazuar".***

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimin e dytë të operatorit ankues me ç'rast ka gjetur se pretendimi i dytë ankimor është i qëndrueshëm. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm si dhe i bazuar dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konkretisht konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimi dhe argumentimi i ekspertit shqyrtues është i mbështetur në LPP dhe legjislacionin sekondar për prokurimin publik. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me këtë pretendim i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.**Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë i Operatorit Ekonomik Ankues është i pabazuar.** Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe dështmitë të cilat i ka dorëzuar Operatori Ekonomik Ankues me rastin e parashtrimit të ankesës. Përndryshe konstatimet e ekspertit shqyrtues të cituara si më sipër mund të konfirmohen edhe përmes këtyre dështmive të prezantuara nga Operatori Ekonomik Ankues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe

objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Po ashtu duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për panelin shqyrtues dhe çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, pohimeve te palëve, akteve dhe veprimeve të tyre, natyrisht duke e pasur parasysh edhe natyrën e shkeljeve eventuale në raport me qëllimin dhe rrjedhën e një aktiviteti të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli Shqyrtues e mbështet ndonjë raport apo ndonjë rekomandim të ekspertizës, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional te panelit ashtu siç i adresohen kompetencat e tilla sipas nenit 105 te LPP. Megjithatë në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se vetëm pretendimi i dytë ankimor është i bazuar e cili nuk ndikon në ndryshim të epilogut përfundimtar, ndërsa pretendimi i parë ankimor është i pabazuar në tërësi ngase kur përcaktohet si term në dosjen e tenderit i specializuar, me të drejtë ka konstatuar eksperti se nënkuptohet që të ketë njohuri dhe ekspertizë të veçantë e specifike në fushën përkatëse. Kështu që, si dëshmi e aftësisë në rastin konkret mund të dëshmohet me diplomë, certifikatë apo licencë për specializimin përkatës".

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportittë datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull "Hartimi i projektit për Galerinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Prishtinë" me numër të prokurimit 207-23-2085-2-2-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **N.N.SH. " Vizion Project "**
- Arkivës së OSHP-së: